



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.702/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, rr. “Armend Dci”, Nr.1, kundër debitorit N.T.P “Tali Com”, me seli në fshatin Strezoc, Komuna e Kamenicës, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm, E.nr.133/2013 të datës 05.12.2022, me datën 29.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit N.T.P “Tali Com”, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm, E.nr.133/2013 të datës 05.12.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan, Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar E.nr.133/2013 të datës 05.12.2022, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit N.T.P “Tali Com”, paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor E.nr.133/2013 i datës 02.07.2013 i lejuar nga Gjykata Themelore në Gjilan-Dega në Kamenicë.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te shkeljes se dispozitave te procedurës përmbartimore, konstatimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike,

dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj ankesën si te bazuar.

Kreditori ka ushtruar përgjigje në ankesë nëpërmjet të cilës ka theksuar se gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktvendim të drejtë, andaj ka kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë që ankesën e debitorit ta refuzoj si të pa bazuar dhe të vërtetoj Aktvendimin E.nr.133/2013.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, ka paraqitur propozim për përmbaremore ndaj debitorit në bazë të dokumentit përmbaremore - E.nr.133/2013 i datës 02.07.2013, me të cilin ka caktuar zbatimin e përmbaremit, ndaj debitorit N.T.P “Tali Com” , me të cilin e ka detyruar që kreditorit t’ia paguaj shumën e borxhit prej 14,208.00 €.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kërkuar nga gjykata që të lejohet prapësimi dhe të pezullohet procedura përmbaremore si e pa bazuar me arsyetim se ndaj kreditorit nuk qëndron kurrfarë detyrimi pasi që debitori prej vitit 2000-2007 ka punuar si operues legal me licensë dhe ka paguar të gjitha detyrimet ndaj kreditorit.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi thëniet në prapësim të debitorit, duke theksuar se propozimi për përmbaremore është bërë i plotfuqishëm sipas nenit 121 të LPP-së dhe është bërë titull ekzekutiv sipas nenit 24 pika b të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe ta lë në fuqi urdhrin për përmbaremore.

Gjykata Themelore në Gjilan, Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar pas vlerësimit të prapësimit ka nxjerrë aktvendimin E.nr.133/2013 të datës 05.12.2022, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit N.T.P “Tali Com”, paraqitur kundër Urdhrit Përmbarrimor E.nr.133/2013 i datës 02.07.2013 i lejuar nga Gjykata Themelore në Gjilan-Dega në Kamenicë.

Në arsyetim të aktvendimit Gjykata e Shkallës së Parë ka vlerësuar se Vendimi E.nr.133/2013 i datës 02.07.2013,, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 22 paragrafin 1, nënpar.2 të LPP-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrit të përmbarruesit privat, me të cilin është caktuar përmbarrimi i propozuar nga kreditori.

Kjo gjykatë vlerëson se E.nr.133/2013 i datës 02.07.2013, është dokument përmbarrues dhe i përshtatshëm për përmbarrim, për faktin se me nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, përcaktohet se: “ *Dokument përmbarrues është edhe vendimi përmbarrues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (me tej: ujdia)*” dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarrimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragraf 3 sepse, po ashtu është në pajtim edhe me nenin 27 paragraf 1 të LPP i cili përcakton se: “*Dokumenti përmbarrimor është i përshtatshëm për përmbarrim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbarrjes së detyrimit*”, ndërsa një dokument përmbarrimor për të shërbyer si titull përmbarrues patjetër duhet të përmbaj elementet e përcaktuara me nenin 27 paragrafi 1, të cilat e bëjnë si dokument të përshtatshëm përmbarrimor. Në bazë të këtij neni del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbarrimor të papërshtatshëm për përmbarrim.

Gjykata e shkalles se dytë ka vlerësuar edhe nenin 36 paragraf 1 të LPP - së, ku përcakton se “ *Së bashku me propozimin për përmbarrim, organit përmbarrues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarrues origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarrueshmërisë për përmbarrueshmëri*”, ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se “ *Vërtetimin për*

përmbareshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë ”. Në rastin konkret kemi të bëjmë me vendim administrativ të formës së prerë, i njëjti është origjinal dhe si i tillë i plotëson kushtet për përmbareshmëri. Arsye këto nga te cilat edhe kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e debitorit janë të paargumentuara dhe si te tilla mbeten vetëm ne natyrën deklarative, te pambështetura ne prova ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP, me çka nuk janë plotësuar as kushtet ligjore nga neni 71 te LPP.

Përndryshe, në procedurën përmbareshmëri bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbareshmëri i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbareshmëri që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbareshmërin.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.702/24, me datë 29.05.2024

Gjyqtarja,
Saranda Bogaj Sheremeti